



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

E.nr.706/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbartimore të kreditorës: T.D., Xh.Sh., M.N. dhe M.G. të cilën e përfaqëson av Urim Bajraktari nga Ferizaj , kundër debitorit Komuna e Ferizaj -Drejtoria e Arsimit, për pagesën e udhëtimit dhe ushqimit si dhe shpenzimet e procedurës, më datë 11.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbartimore në lëndën **E.nr.706/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorës.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.706/23, të datës 15.05.2023, e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit, kundër debitorit Komuna e Ferizajt -Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpenzimeve , ushqimit dhe udhëtimit e të ardhurave personale si dhe shpenzimeve të procedurës kontestimore , në bazë të pajtimit gjyqësor 2022:076508 të datës 02.08.2022.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbartimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 21.09.2023,e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 1,865.00 euro , në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit.

Meqenëse kreditorët e kanë realizuar kërkesën e tyre, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbartimore në këtë çështje juridike përmbartimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.706/23 më datë 11.06.2024

GJYQTARI
Faton Ajvazi